



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3782/2 Prot

Gramsh më 07. 12.2022

VENDIM

Nr.77 , dt.30/09/2022

PËR

PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË SHTETASIT BESNIK KOKLA PËR SHKAK TË DIEGJES SË MAGAZINËS NGA RËNIA E ZJARRIT, NË FSHATIN GRIBË, NJËSIA ADMINISTRATIVE KUKUR, BASHKIA GRAMSH.

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës **30. 09.2022**, bazuar në kërkesën e shtetasit Besnik Kokla si dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, për miratimin e vlerës financiare të dëmeve në kulturat bujqësore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore, rënia e zjarrit për familjen e z.Besnik Kokla, dhe shpërblimin financiar nga ana e bashkisë mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligji 10296 datë 08/07/2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “, ligjin 137/2020 datë 16/11/2020 “Për buxhetin e vitit 2022” , si dhe Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,

V E N D O S I:

1. Të miratojë në parim vlerën financiare të dëmeve në kulturat bujqësore të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore rënie zjarri për familjen e z. Besnik Kokla, ndodhur në fshatin Gribë, Njësia Administrative Kukur, sipas preventivit të hartuar nga specialistët e bashkisë Gramsh, përkatësisht në masën:
 - **2 078 800 lekë (dy million e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë.**

2. Të akordojë ndihmën financiare ndaj shtetasit Besnik Kokla afësisht në masën **50 % të shumës së preventivit**, përkatësisht 1 000 000 (një milion) lekë.
3. Ndihma financiare do të përballohet nga fondi Bashkisë Gramsh.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e të Ardhurave, Zhillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të Prefektit.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

GRETA LENA



Konceptoi: Xh. Gjini

Pranoi: G. Lena

Dosja nr: _____

Afati i ruajtjes: _____